



DEKRIMINALIZIMI NË SHQIPËRI

SHKURT-MAJ 2025

Instituti i Studimeve Politike (ISP) është duke monitoruar KQZ dhe fushatën elektorale, si pjesë të angazhimit në projektin “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Pikëpamjet e shprehura në raport janë përgjegjësi e ISP-së.

ISP

Dekriminalizimi në Shqipëri

Shkurt-Maj 2025

Përmbajtja

Gjetjet Kyesore.....	4
Hyrje	6
A po fitohet beteja e dekriminalizimit?	8
Organet e drejtësisë dhe dekriminalizimi	9
Strukturat ligjzbatuese dhe dekriminalizimi	12
Politika dhe dekriminalizimi	12
Përfundime	14
Referencat.....	15

Gjetjet Kyesore

- SPAK vijon të ndërmarrë akte të forta kundër korrupsionit në nivele të larta dhe krimin të organizuar duke ndihmuar në mënyrë të drejtpërdrejtë procesin e dekriminalizimit të jetës politike dhe institucionale të Shqipërisë. Gjatë periudhës shkurt-maj 2025, SPAK ka regjistruar gjithsej 45 raste procedimi penal ndaj zyrtarëve të lartë, përfshirë arrestin me burg të kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe numrit dy të Partisë Socialiste. Edhe Prokuroria e Përgjithshme ka regjistruar gjithsej 46 procedime penale, kryesish për shpërdorim detyre dhe korrupsion pasiv.
- Organet e tjera ligjzbatuese si Policia e Shtetit dhe Agjensia e Mbikqyrjes Policore kanë trajtuar shkelje ligjore që lidhen me shpërdorimin e detyrës, korrupsionin pasiv dhe shkelje të kodit të etikës në punë. Policia e Shtetit ka regjistruar gjithësj 52 procedime ndërsa AMP ka trajtuar ose referuar në Prokurori 46 shkelje. Por siç tregojnë rastet në të shkuarën dhe zgjedhjet e 11 majit 2025, regjistrimi e veprave penale pa një vendim përfundimtarë gjyqësorë dhe vullnet nga institucionet respektive nuk garanton jetësim të plotë parimeve të dekriminalizimit.
- Kur kanë kaluar 10 vite nga miratimi i ligjit të dekriminalizimit, ndarja e politikës dhe jetës institucionale nga ndikimi i botës së krimin dhe personave me rekorde korruptive mbetet akoma sfidë për Shqipërinë. Rezistenca ndaj procesit të dekriminalizimit ka marrë formë dhe metoda më të sofistikuar. Mbështetja e kandidatëve apo promovimi në funksionet publike të individëve të tretë nga rrjetet kriminale dhe interesat klienteliste ka ndërtuar mekanizma informale të ndikimit në vendimarrjen publike dhe proceset politike.
- Një pjesë e mirë e partive politike dhe institucioneve publike vazhdojnë të promovojnë ose kandidojnë për poste përfaqësuese persona me rekorde korrupsioni në funksione publike në një përpjekje për tu ofruar mbrojtje politike nga veprimet e drejtësisë. Partitë nuk verifikuan paraprakisht në mënyrë serioze nëse kandidatët për deputet kanë lidhje me krimin e organizuar apo janë përfshirë në korrupsion. Në disa zona elektorale si në Durrës, Elbasan, Tiranë dhe Shkodër individë pa veprimtari publike politike arritën të marrin një numër votash personale rekord në raport me kandidatët e tjerë. Kjo ka ngritur dyshime për burimin e fuqisë së tyre elektorale dhe lidhje të mundshme informale me grupet kriminale.

- Strukturat e drejtësisë, veçanërisht SPAK dhe GKKO, por edhe organet ligjzbatuese janë të ekspozuara ndaj dobësive strukturore si mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, dhe varësia nga mbështetja ndërkombëtare. Pa krijimin e një tradite dhe kapaciteteve institucionale organike, të qëndrueshme dhe autonome, Shqipëria do të ketë të vështirë ta fitojë në mënyrë të plotë dhe përfundimtare betejën e dekriminalizimit.

Hyrje

Me fillimin e tranzicionit të Shqipërisë nga sistemi komunist drejt demokracisë u shfaqën fenomene të reja dhe sfiduese për konsolidimin demokratik. Eksponentë të krimit të organizuar dhe persona me rekorde korrupsioni u bënë fillimisht në mënyrë të tërthortë pjesë e procesve politike dhe vendimarrëse, por pas zgjedhjeve të vitit 2013 lidhjet e politikës me krimin e organizuar u ndërthurën në mënyrë më simbiotike. Ndryshe nga praktikat në të shkuarën ku politika përdorte grupet kriminale për favore elektorale dhe lidhje biznesi në prapaskenë, me zgjedhjet e vitit 2013 dhe në vijim individë me të shkuar kriminale depërtuan në institucionet më të larta përfaqësuese dhe kushtetuese të shtetit, përfshirë Kuvendin, të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore dhe vendore. Raporti i OSBE/ODIHR për zgjedhjet e vitit 2013 vuri theksin tek praktikat e blerjes së votës dhe presionit ndaj votuesve nga grupet kriminale, duke ekspozuar lidhjet e mundshme mes krimit dhe politikës.¹ Po ashtu gjetjet e raportit të vitit 2015 të Freedom House dhe organizatave të tjera ndërkombëtare nxorën në dritë lidhjet e drejtpërdrejta të krimit të organizuar dhe politikës.²

Në një kontekst të tillë ku individë me rekorde kriminale depërtuan në vijën e parë të vendimarrjes politike në Shqipëri, opozita e kohës dhe faktori ndërkombëtar ushtruan trysni që të miratoheshin mekanizma ligjor për këputjen e lidhjeve të shtetit me krimin. Kështu, nën presionin e faktorit ndërkombëtar në Tiranë, Kuvendi i Shqipërisë miratoi në vitin 2015 ligjin 138/2015 ‘për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’ i njohur ndryshe në hapësirën publike si ligji i dekriminalizimit. Ligji krijoi një instrument të fortë institucional për pengimin e zgjedhjes ose emërimit dhe largimit nga funksionet publike të personave të dënuar apo ndaj të cilëve janë marrë masa sigurie ose janë dënuar me vendim jopërfundimtar për kryerjen veprave penale.³ Pra, objektivi i ligjit është të garantojë institucione të pastra publike dhe përfaqsim politik cilësor duke rritur rrjedhimisht besimin e publikut tek organet e zgjedhura shtetërore, institucionet e pavarura dhe atyre të krijuara me ligj.

Miratimi i ligjit të dekriminalizimit solli si pasojë largimin nga institucionet qendrore, veçanërisht nga Kuvendi dhe këshillat bashkiak, të individëve me të shkuar kriminale si pasojë e

¹ OSCE/ODIHR. (2013). *Republic of Albania parliamentary elections, 23 June 2013: OSCE/ODIHR election observation mission final report*. Organization for Security and Co-operation in Europe, Office for Democratic Institutions and Human Rights. <https://www.osce.org/odihr/elections/107069>

² Likmeta, Besar. "Study Finds Albanian Crime Had Political Ties for 25 Years." *Balkan Insight*, December 1, 2017. <https://balkaninsight.com/2017/12/01/study-find-that-for-25-years-of-albanian-crime-had-political-ties-12-01-2017/>
Freedom House. *Nations in Transit 2015: Albania Country Report*. Washington, DC: Freedom House, 2015. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2015>

³ Neni 1, Ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kuvendi i Shqipërisë, datë 17.12.2015.

presionit të opinionit publik dhe faktorit ndërkombëtarë. Dhjetra deputetë, kryetarë bashkie, si dhe qindra këshilltarë lokalë dhe punonjës të administratës publike u larguan nga funksionet shtetërore si pasojë e ligjit të dekriminalizimit.⁴ Të gjendur nën trysinë e faktorit ndërkombëtar, medias dhe shoqërisë civile, partitë politike miratuan kode etike dhe rregullore të brendshme që synonin pengimin e kandidimit apo promovimit në funksionet e larta publike të individëve me të shkuar kriminale. Këto masa reflektuan në vijimësi rënien graduale të numrit të kandidatëve apo emërimin në zyrat e larta të shtetit të personave me të shkuar kriminale dhe korruptive.⁵

Megjithatë, jetësimi i parimeve të dekriminalizimit në mënyrë organike dhe të pavarur nga presioni i institucioneve ndërkombëtare vijon të mbetet sfidë aktuale për Shqipërinë. Së pari, format e ndikimit të eksponentëve të krimit të organizuar dhe individëve të përfshirë në korrupsion në vendimarrjen politike kanë ndryshuar. Ndryshe nga vitet e shkruara, personat me lidhje kriminale qëndrojnë në prapaskenë dhe promovojnë në mënyrë informale njerëzit e tyre të preferuar në poste publike. Një pjesë e mirë e akteve vetërregulluese të institucioneve përfaqësuese, policisë së shtetit dhe administratës publike mbeten formale, dhe për rrjedhim pa efektin e kërkuar integral nga ligji i dekriminalizimit.⁶ Së dyti, nivelet e ulta të administratës publike dhe institucioneve të tjera të pavarura janë kthyer në strehë të personave të botës së krimit për shkak të vëmendjes së ulët të medias, opinionit publik dhe pragmatizmit politik. Së treti, partitë politike vijojnë të promovojnë në funksione politike individë të dyshuar me lidhje me krimin e organizuar apo përfshirje në akte korruptive duke sfiduar ligjin e dekriminalizimit.⁷ Në një kohë kur Shqipëria po progreson në hapjen e kapitujve për antarësim në BE dhe ka një klimë pozitive në Bruksel kundrejt hapave që po bën Tirana në këtë proces në kohë ndryshimesh dhe sfidash gjeopolitike, jetësimi gjithëpërfshirës i ligjit të dekriminalizimit dhe këputjes së lidhjeve informale të politikës me individë me rekorde kriminale apo korruptive do të jetë shtysë për përmbylljen me sukses të negociatave me BE.

Forcimi i institucioneve të drejtësisë, veçanërisht funksionaliteti i plotë i SPAK (Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar) ka ekspozuar gjithnjë e më shumë përfshirjen e zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të lartë në korrupsion dhe lidhjen e funksionarëve të policisë së shtetit dhe politikës me krimin e organizuar. SPAK e ka ndihmuar procesin e dekriminalizimit duke hetuar në mënyrë më të sofistikuar dhe proaktive korrupsionin në nivele të larta dhe krimin e organizuar, duke prodhuar kështu produkte konkrete në procesin e

⁴ Shiko statistikën e ISP tek <https://dekriminalizimi.isp.com.al/>

⁵ ISP. (2024). Integriteti i zyrtarëve të zgjedhur – Raport monitorues për qarqet Kukës, Dibër e Shkodër 2023-2024. <https://isp.com.al/integriteti-i-zyrtareve-te-zgjedhur-raport-monitorues-per-qarqet-kukes-diber-e-shkoder-2023-2024>
Shiko gjithashtu ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023. <https://dekriminalizimi.isp.com.al/dekriminalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

⁶ “Ligji i dekriminalizimit, një dështim!/: Politika ende e inkriminuar edhe pas 7 vitesh”. *Top News*. <https://www.youtube.com/watch?v=gxupyEzARR8>

⁷ Karaj, Vladimit. Challenging Justice: Albanian Parties Field Candidates Facing Corruption Charges. *Balkan Insight*, April 24, 2025. https://balkaninsight.com/2025/04/24/challenging-justice-albanian-parties-field-candidates-facing-corruption-charges/?utm_source=chatgpt.com

dekriminalizimit.⁸ Por, SPAK është një strukturë me fushë veprimi të kufizuar në nivelet e larta dhe me kapacitete njerëzore dhe financiare të pamjaftueshme për procedime në të gjithë spektrin e veprimtarisë kriminale dhe korruptive. Prandaj, megjithë progresin e bërë në këtë drejtim, dekriminalizimi vijon të jetë temë në debatin politik dhe publik veçanërisht gjatë periudhës parazgjedhore, gjatë dhe pas zgjedhjeve. Ndërmarrja e akte akteve parandaluese si verifikimi paraprak i pastërtisë së figurës të individëve që kandidohen për poste politike nga partitë politike apo nominohen për funksione të larta publike mbetet e pamjaftueshme.

Ky raport analizon progresin në procesin e dekriminalizimit gjatë periudhës shkurt-maj 2025. Raporti përqëndrohet në mënyrë të veçantë tek veprimet e institucioneve të drejtësisë dhe atyre ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar si parakusht për pastrimin e politikës dhe shtetit nga individët me të shkuar kriminale dhe të përfshirë në korrupsion. Niveli i suksesit në këtë drejtim do të jetë përcaktues jo vetëm për shpejtësinë e antarësimit të vendit në BE, por mbi të gjitha për maturinë demokratike të Shqipërisë në mënyrë të qëndrueshme.

A po fitohet beteja e dekriminalizimit?

Raporti i fundit i Komisionit Evropian për Shqipërinë, i publikuar në tetor 2024, vlerëson progresin e vendit në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, por thekson se mbeten sfida të konsiderueshme që kërkojnë përpjekje të mëtejshme: korrupsioni mbetet i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit, duke përfshirë të gjitha degët e qeverisjes qendrore dhe vendore – masat parandaluese kanë ndikim të kufizuar – dhe kultura e mosndëshkimit në nivelet e larta të shtetit mbetet problematike.⁹ Pra, megjithë progresin në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, veçanërisht në nivele të larta, pyetja mbetet: a po bën Shqipëria hapa para në ndarjen e shtetit nga individët me të shkuar kriminale dhe korruptive?

Ligji i dekriminalizimit është një nga aktet më radikale në demokracitë në tranzicion. Por, imponimi i ligjit nga faktorit ndërkombëtar në mungesë të një mbështetje organike nga aktorët politik në vend ka krijuar probleme me implementimin gjithëpërfshirës të ligjit, dhe veçanërisht me verifikimet paraprake të cilat mbeten në vullnetin e partive politike dhe institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Dekriminalizimi parashikon (neni 2; 3 dhe 14) ndalimin

⁸ Shiko, Performance Assessment: Measuring Effectiveness, Monitoring Progress and Enhancing Accountability of Special Prosecution (SPAK) and Special Courts Against Corruption and Organised Crime (2020-2023) 4th Assessment Report. CSDG. https://csdgalbania.org/publications/SPAK_Report_2020-2023_ENG.pdf

⁹ Albania Report 2024. EU Commission: Brussel. Final 2024. https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

e kandidimit apo emërimit si dhe përfundimin e mandatit/funksionit publik të personave që gjenden në papajtueshmëri me dispozitat e ligjit. Ligjit gjithashtu (neni 11;12;13) ngarkon institucionet përkatëse që të kryejnë verifikime paraprake të pastërtisë së figurës së personave që kandidohen apo propozohen për funksione të larta politike dhe publike. Megjithatë, qasja radikale në ligj duket se nuk është e mjaftueshme për jetësimin gjithëpërfshirës të parimeve të dekriminalizimit. Kultura e dobët politike dhe institucionale, ndërthurja e interesave elektorale dhe të biznesit, klientelizmi dhe mungesa e traditës demokratike brenda partive politike ka minuar objektivat parandalues të ligjit. Prandaj, forma më efektive e implementimit të dekriminalizimit mbetet hetimi dhe vendosja përpara ligjit e individëve me rekorde kriminale dhe korruptive.

Organet e drejtësisë dhe dekriminalizimi

Hetimi dhe dërgimi për gjykim nga SPAK i zyrtarëve të lartë të përfshirë në korrupsion apo me lidhje me krimin e organizuar ndihmon veprimin e ligjit të dekriminalizimit dhe për rrjedhojë shkëputjen e institucioneve publike nga ndikimet korruptive dhe kriminale. Gjatë periudhës shkurt-maj 2025, SPAK ka regjistruar gjithsej 45 raste procedimi penal ndaj zyrtarëve të lartë. Në raport me shpërndarjen gjeografike, numri më i lartë i rasteve është regjistruar në Tiranë me 32 procedime, ndjekur nga Vlora dhe Himara me nga 3 raste secila, Tropoja me 2 raste, ndërsa Saranda, Fieri, Elbasani, Kukësi dhe Durrësi kanë nga 1 rast. Ndërkohë kryebashkiku i Tropojës dhe ish-kryetari i Bashkisë së Himarës janë dërguar për gjykim në GKKO. Në tërësi SPAK ka proceduar gjatë kësaj periudhe në nivele të larta 5 kryetarë bashkie, zv/kryetarë, ish-kryetarë dhe titullarë në bashki; 2 ish-drejtorë të Drejtorisë së Mbrojtjes dhe Menaxhimit të Tokës, si dhe 2 prokurorë.

Në shkurt SPKA urdhëroj arrestimin e kryebashkiakut të Tiranës i cili akuzhet për korrupsion pasiv dhe pastrim parash.¹⁰ Mirëpo kryebashkiaku Veliaj edhe pse nën masën arrest me burg vijon formalisht të qëndrojë në krye të Bashkisë Tiranë. Menjëherë pas arrestimit të Erion Veliaj, kryeministri nisi një fushatë sulmesh ndaj SPAK.¹¹ Përpos kësaj, një grup i organizuar protestuesish ushtruan trysni ndaj trupës gjyquese të GKKO ndërsa ajo merrte vendim për masën e sigurisë ndaj kryebashkiakut Veliaj.¹² Pavarësisht se gjuha kritike e kryeministrit dhe format e presionit të organizuar në formë protestash publike ndaj SPAK dhe GKKO për rastin Veliaj u davarit brenda një kohe të shkurtër nën dritën e një strategjie të mirëmenduar elektorale, kritikant

¹⁰ DW. Shqipëri: SPAK arreston kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj. 10 shkurt 2025.

<https://www.dw.com/sq/shqip%C3%ABri-spak-arreston-kryebashkiakun-e-tiran%C3%ABs-erion-veliaj/a-71565148>

¹¹ Blerina Gjoka. Edi Rama: SPAK ka dalë nga shinat, Veliaj nuk do të shkarkohet. Reporter.al, 11 shkurt 2025. <https://www.reporter.al/2025/02/11/edi-rama-spak-ka-dale-nga-shinat-veliaj-nuk-do-te-shkarkohet/>

¹² Edmond Hoxhaj. Mbështetësit e Veliajt, 'antimiting' në SPAK kundër arrestimit të tij. Reporter.al, 12 shkurt 2025. <https://www.reporter.al/2025/02/12/mbeshtetesis-e-veliajt-antimiting-ne-spak-kunder-arrestimit-te-tij/>

e organizuara nga mbledhjet e grupit parlamentar të partisë në pushtet sinjalizojnë se elita politike është e gatshme të reduktojë ose t'i rezistojë veprimeve të drejtësisë ndaj njerësve apo interesave të veta politike. Në momentin që flasim, Partia Socialiste nuk ka ndërmarrë asnjë akt konkret sesi do ta adresojë pozitën politike të Erion Veliaj në forumet partiake apo në krye të Bashkisë Tiranë. Megjithëse, kryebashkiakut nuk i është ofruar mbështetje politike publike gjatë kësaj periudhe, mungesa e akteve formale tregon për kulturën e dobët demokratike dhe angazhimin anemik ndaj parimeve të dekriminalizimit.

SPAK ka vepruar edhe ndaj funksionarëve të tjerë në nivel më të ulta të cilët akuzohen për korrupsion dhe shpërdorim detyre. Konkretisht është proceduar 1 avokat; 2 titullarë autoritetesh kontraktore; 1 auditues i KLSH-së; 1 jurist; 2 deputetë, 5 oficerë të policisë gjyqësore, si dhe një numër punonjës policie, shefa komisaratesh dhe hetimi. Sa i përket veprave penale të hetuara nga SPAK, 'shkelja e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike' përbën veprën më të përhapur me 23 raste, disa prej të cilave janë kryer në bashkëpunim. 'Korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike në bashkëpunim' rezulton në 11 raste, ndërsa 'shpërdorimi i detyrës' është regjistruar në 5 raste. Në lidhje me këto procedime janë vendosur masa sigurie nga arresti me burg deri tek sekuestro pasurie dhe janë dërguar për gjykim 20 çështje.

Në të njëjtën kohë SPAK ka goditur grupe kriminale të përfshira në trafikë ndërkombëtare dhe pastrim parash. Në maj 2025 Prokuroria e Posaçme në koordinim me strukturat ligjzbatuese partenere dhe Policinë e Shtetit ka lëshuar 52 masa sigurie dhe ka zbatuar rreth 40 prej tyre, duke arrestuar individë të përfshirë në aktivitete kriminale.¹³ Ndërsa këto veprime shënojnë progres në luftën kundër krimit të organizuar, nuk garantojnë implementim gjithëpërfshirës të parimeve të dekriminalizimit. Së pari, edhe pse ligji i dekriminalizimit është një mekanizëm radikal dhe *siu generis* në shumë drejtime, nuk parashikon sanksione për lidhje të papërshtatshme informale mes zyrtarëve të lartë publik dhe rrjeteve kriminale. Kjo mangësi juridike lë shteg për transformimin e ndikimi të krimit të organizuar në forma të kamufluara dhe të tërthorta në vendimarrjen politike duke mbështetur apo promovuar në funksione përfaqësuese si Kuvendi individë formalisht të pastër. Së dyti, procedimi dhe gjykimi i personave të përfshirë në veprimtari kriminale është shpesh një proces i gjatë dhe kompleks, duke pamundësuar veprimin e menjëhershëm të ligjit të dekriminalizimit. Ky fakt, iu ka dhënë mundësi partive politik të instrumentalizojnë fuqinë ekonomike dhe elektorale të grupeve kriminale për të siguruar avantazh elektorale.

¹³SPAK. Njoftim për shtyp, Datë 21.05.2025 <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-21-05-2025/>




Tabela nr.1: Nurmi i çështjeve të proceduara/referuara nga institucionet e drejtësisë dhe zbatimit të ligjit, shkurt-maj 2025

Përpos SPAK, një rol me rëndësi në procesin e dekriminalizimit ka edhe Prokuroria e Përgjithshme. Gjatë pesëmuajorit të parë të vitit 2025 janë regjistruar gjithsej 46 raste të ndjekura nga Prokuroria e Përgjithshme. Prilli është muaji me numrin më të lartë të rasteve (19 raste), që përbën pothuajse gjysmën e të gjithë rasteve të kësaj periudhe. Janari dhe shkurti kanë nga 10 raste secili, ndërsa marsi ka një rënie të lehtë me 7 raste. Në muajin maj nuk është regjistruar asnjë rast, duke sugjeruar një ndalesë ose vonesë në referimet apo veprimet procedurale. Pjesa më e madhe e procedimeve të Prokurorisë së Përgjithshme janë ndërmarrë ndaj funksionarëve publik me risk të lartë korrupsioni si Agjensia Shtetërore e Kadastrës dhe Policia e Shtetit. Lidhjet e funksionarëve të Policisë së Shtetit me krimin e organizuar janë raportuar në vijim si shqetësuese për standartet e sundimit të ligjit dhe policimit profesional.¹⁴

Megjithëse procedimet ndaj zyrtarëve publik kontribuojnë pozitivisht në jetësimin integral të ligjit të dekriminalizimit, problem mbetet mungesa e verifikimeve paraprake nga vetë institucionet, si mungesa e mekanizmave të brendshëm funksional të vlerësimit të figurës së punonjësve. Shqipëria ka një ligj të mirë të bilbilfryrsve, por në nivel praktik ndikimi e këtij mekanizmi të brendshëm kontrolli dhe parandalimi të abuzimit me detyrën mbetet minimal. Kultura e pamjaftueshme administrative dhe mungesa e besimit tek institucionet publike ka pamundësuar vlerësimet e brendshme efektive dhe për rrjedhojë edhe veprimin e pamjaftueshëm dhe praktikën parandaluese të ligjit të dekriminalizimit.

¹⁴ GI, Integrity and independence of criminal justice institutions in the Western Balkans. 2024: Final report. <https://globalinitiative.net/analysis/integrity-and-independence-of-criminal-justice-institutions-in-the-western-balkans/>

Strukturat ligjzbatuese dhe dekriminalizimi

Policia e Shtetit dhe Agjensia e Mbikqyrjes Policore (AMP) vijojnë të kontribuojnë në mënyrë të tërthortë në procesin e derkriminalizimit nëpërmjet veprimeve kundër abuzimit me detyrën apo përfshirjen në korrupsion. Policia e Shtetit ka regjistruar gjithsej 78 procedime, kryesisht për shpërdrim detyre apo korrupsion pasiv. Pjesa më e madhe e zyrtarëve të proceduar janë punonjës të Agjensisë Shtetërore të Kadastrës, OSHE dhe Policisë së Shtetit, duke demonstruar një risk të lartë të përfshirjes në vepra penale të zyrtarëve publik në agjensi kritike shtetërore. Në shumicën e rasteve Policia e Shtetit mjaftohet me procedime penale ndaj këtyre individëve. Kjo do të thotë se pa vullnet politik dhe mekanizma të brendshëm institucional, ligji i dekriminalizimit e ka të pamundur të veprojë ndaj personave që nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë apo për vepra penale të parashkuara në ligj. Me fjale të tjera, këta individë edhe pse nën hetim, vijojnë në një masë të madhe të ushtrorjës funksione publike, duke minuar kështu jetësimin integral të parimeve të dekriminalizimit.

Ndërkohë, AMP ka trajtuar apo referuar në prokurori rreth 53 shkelje nga strukturat e policisë. Veprat më të përhapura mbeten shpërdorimi i detyrës, shkeljet etike në punë ose korrupsion pasiv. Vite më parë u iniciua një proces vettingu (vlerësim i pastërtisë së figurës dhe integritetit të oficerëve të policisë) i cili synonte formalisht kontrollin e aftësive profesionale, lidhjeve me krimin dhe korrupsionin. Objektivi kryesor i deklaruar i vettingut në polici ishte pastrimi nga rradhët e organizatës të oficerëve të papërshtatshëm. Megjithatë, procesi i vettingut u reduktuar vetëm në funksionarët e lartë të Policisë së Shtetit pas shqetësimeve se do të krijoheshin vakanca dhe ndikime politike në proces.¹⁵ Por, progresi i ngadaltë i vettingut ndaj funksionarëve të lartë të Policisë së Shtetit dhe shqetësimet për mungesë pavarësie politike në procesin e administruar nga AMP kanë pamundësuar veprimin në kohë të ligjit të dekriminalizimit.¹⁶

Politika dhe dekriminalizimi

Objekti kryesor i ligjit të dekriminalizimit janë partitë politike të cilat nëpërmjet pjesëmarrjes në jetën politike, garimin në zgjedhje dhe përfaqësimin në Kuvend, kompozojnë institucionet kryesore përfaqësuese dhe kushtetuese. Megjithëse ligji parashikon mekanizma për verifikimin e kandidatëve për poste politike si në Kuvend apo qeveri, partitë politike kanë përgjegjësi që të kryejnë verifikime paraprake dhe kandidojnë individë të pastër dhe me integritet. Ligji në vetvete

¹⁵ GRECO. Fifth evaluation round Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies. COMPLIANCE REPORT, ALBANIA. 2023.

¹⁶ GI-TOC. Integrity and independence of criminal justice institutions in the Western Balkans Police and prosecution. 2024. <https://globalinitiative.net/analysis/integrity-and-independence-of-criminal-justice-institutions-in-the-western-balkans/>

ka qenë përgjithësisht efektiv në largimin nga zyra të një numri të lartë drejtuesisht qysh me miratimin e tij në vitin 2015. Por, efektet parandaluese të ligjit kanë qenë minimale sepse mbi të gjitha kërkohet vullnet politik nga aktorët institucional. Shqipëria mbajti zgjedhjet e 11-ta të përgjithshme në 11 maj 2025 dhe ky ishte një moment tjetër testi jo vetëm për procesin zgjedhor, por edhe për integritetin e kandidatëve për deputet dhe angazhmin e partive politike për një politikë të pastër.

Pavarësisht se dekriminalizimi mbetet një objektiv i rëndësishëm për rrugën e Shqipërisë drejt demokracisë funksionale dhe antarësimit në BE, asnjë parti politike nuk realizoj verifikime paraprak të kandidatëve për rekordet e dekriminalizimit dhe as tek Autoriteti i Dosjeve. Përkundrazi, duket se pati një rezistencë publike të partive politike ndaj ligjit të dekriminalizimit sepse në disa zona zgjedhore historikisht me risk të lartë për ndikimin e krimit në zgjedhje, u përfshinë në listat e kandidatëve individë nën hetim për korrupsion ose persona me lidhje informale me krimin. Brenda listave shumë-emërore të partive politike u përfshinë individë nën hetime zyrtare nga SPAK ose në proces gjykimi nga GJKKO. Në qarkun e Tiranës, Durrësit, Elbasanit dhe Shkodrës, persona ose lidhje familjare të individëve nën sanksione nga SHBA për përfshirje në korrupsion u vendosën në listën e kandidatëve për deputet, duke sfiduar hapur parimet e dekriminalizimit. PSD e drejtuar nga një politikan nën sanksione nga SHBA arriti të sigurojë përsëri tre mandate në Kuvendin e Shqipërisë pa zhvilluar aktivitet politik dhe jetë parlamentare të rregullt. Ndërkohë, edhe në Durrës një individ pa profil dhe me aktivitet politik minimal publik arriti një numër rekord votash personale, duke kaluar edhe nurmin e votave të kryministrit në këtë qark në vitin 2021. Ky trend, ka ngritur shqetësime se krimi i organizuar po ndikon në mënyrë informale në zgjedhje dhe mandej në vendimarrjen politike duke mbështetur persona të tretë në garën për vende në Kuvendin e Shqipërisë.¹⁷ Po kështu edhe në Elbasan, një kandidate 29- vjeçare me një profil modest publik, rezultoi më e votuara mes të gjithë socialistëve në listat e hapur duke ngritur pikëpyetje rreth burimit të fuqisë së saj të madhe elektorale dhe politike.¹⁸

Siç kanë treguar ngjarjet në të shkuarën në Durrës apo Tiranë, këto raste ka gjasë të jenë vetëm maja e *ajdsbergut* në procesin e nominimit të kandidatëve me lidhje të papërshtatshme informale me interesat biznesit apo krimit të organizuar. Ndërsa ligji i dekriminalizimit ofron instrumente për veprim *post-factum*, mungesa e një dispozite ligjore që sanksionon edhe lidhjet e papërshtatshme të zyrtarëve të zgjedhur apo emëruar ka krijuar shteg për forma të sofistikuar ndikimi të krimit të organizuar në proceset politike. Për më tepër, mungesa e kulturës demokratike brenda partive politike dhe tendenca për të kapitalizuar elektoralisht çdo ndikim të krimit në zona të caktuara po pamundëson jetësimin gjithëpërfshirës të ligjit të dekriminalizimit. Në këtë kontekst, duhet parë mundësia që ligji të veprojë jo vetëm ndaj individëve të proceduar apo të dënuar, por edhe ndaj kontakteve të papërshtatshme të zyrtarëve të lartë me botën e krimit.

¹⁷ Geri Emiri. Krimi i organizuar “orientoi” votën në Durrës. 11 maj 2025. Reporter.al.
<https://www.reporter.al/2025/05/11/krimi-i-organizuar-orientoi-voten-ne-durres/>

¹⁸ Vladimir Karaj. Sara Mila, ‘fenomeni i çuditshëm’ i zgjedhjeve të Elbasanit. 15 maj 2025. Reporter.al.
<https://www.reporter.al/2025/05/14/sara-mila-fenomeni-i-cuditshem-i-zgjedhjeve-te-elbasanit/>

Përfundime

Siç shikohet nga të dhënat e mësipërme, sturkturat e zbatimit të ligjit kanë ndërmarrë akte konkrete në luftën kundër veprave penale si korrupsioni dhe veprimtari të krimit të organizuar. Këto veprime ndihmojnë procesin e dekriminalizimit në mungesë të vullnetit politik dhe institucional për të kryer verifikime paraprake dhe kandiduar apo emëruar persona me lidhje kriminale apo korruptive. Goditja e kulturës së pandëshkueshmërisë, posaçërisht në nivele të larta këput lidhjet e shtetit me individët e përfshirë në korrupsion apo aktivitete kriminale. Ligji i dekriminalizimit parashikon sanksione konkrete në rast papajtueshmërie me dispozitat e tij. Prandaj, procedimi penal dhe gjykimi përfundimtar i çështjeve është përcaktues për veprimin gjithëpërfshirës të parimeve të dekriminalizimit.

Megjithatë, aktet e institucioneve të drejtësisë dhe strukturave ligjzbatuese duhet të ndërmerren në kohë për të krijuar efekte parandaluese të ligjit. Ndërsa veprimet e SPAK ndaj zyrtarëve të lartë dhe krimit të organizuar janë jetike për procesin e dekriminalizimit, kryerja në kohë dhe në përputhje me procedurat ligjore është gjithashtu me rëndësi për progresin e Shqipërinë drejt shtetit të së drejtës, funksionarëve politik dhe proceseve elektorale me integritet. Zbatimi i masave të sigurisë ndaj krimit të organizuar vetëm pak ditë pas përfundimit të zgjedhjeve të përgjithshme të 11 majit ka ngritur shqetësime për kohën dhe aftësinë e SPAK për të parandaluar ndikimin e botës së krimit në zgjedhje. Në një kohë kur format e rezistencës ndaj dekriminalizimit janë sofistikuar me ndikime informale në proceset politike nëpërmjet mbështetjes së personave të tretë në zgjedhjet e përgjithshme apo vendore, veprimi në kohë kundër krimit të organizuar merr rëndësi parësore për efektet parandaluese të ligjit por edhe për integritetin e procesve elektorale dhe politike. Mbi të gjitha, depërtimi i individëve me lidhje informale me interesa të dyshimta biznesi dhe krimin e organizuar në organet përfaqësuese si Kuvendi kërkojnë që ligji të sanksionojë dhe kontaktet e papërshtatshme me botën e krimit.

Së fundi, megjithëse janë bërë hapa para në jetësimin e parimeve të dekriminalizimit, varësia e strukturave të reja të drejtësisë nga mbështetja ndërkombëtare, reduktimi i ndihmës së huaj dhe tërheqja e aktorëve perëndimor nga promovimi i vlerave demokratike do ta vështirësojë ndarjen e politikës dhe shtetit nga ndikimet e krimit të organizuar dhe interesat korruptive. Forcimi organik, autonom dhe i qëndrueshëm e struktura të drejtësisë, organeve ligjzbatuese dhe vullneti i brendshëm politik mbeten përcaktuese për maturimin demokratik dhe rrugën evropiane të Shqipërisë.

Referencat

Albania Report 2024. EU Commission: Brussel. Final 2024.

https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

Crime (2020-2023) 4th Assessment Report. CSDG.

https://csdgalbania.org/publications/SPAK_Report_2020-2023_ENG.pdf

DË. Shqipëri: SPAK arreston kryebashkiakun e Tiranës Erion Veliaj. 10 shkurt 2025.

<https://ëëë.dë.com/sq/shqip%C3%ABri-spak-arreston-kryebashkiakun-e-tiran%C3%ABs-erion-veliaj/a-71565148>

Freedom House. *Nations in Transit 2015: Albania Country Report*. Ëashington, DC: Freedom House, 2015. <https://freedomhouse.org/country/albania/nations-transit/2015>

ISP. (2024). Integriteti i zyrtarëve të zgjedhur – Raport monitorues për qarqet Kukës, Dibër e Shkodër 2023-2024. <https://isp.com.al/integriteti-i-zyrtareve-te-zgjedhur-raport-monitorues-per-qarqet-kukes-diber-e-shkoder-2023-2024>

ISP. (2023). Dekriminalizimi dhe integriteti: Raport me gjetje dhe rekomandime 2021-2023.

<https://dekrimalizimi.isp.com.al/dekrimalizimi-dhe-integriteti-raport-me-gjetje-dhe-rekomandime-2021-2023/>

Karaj, Vladimit. Challenging Justice: Albanian Parties Field Candidates Facing Corruption

Charges. *Balkan Insight*, April 24, 2025. https://balkaninsight.com/2025/04/24/challenging-justice-albanian-parties-field-candidates-facing-corruption-charges/?utm_source=chatgpt.com

Ligji 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kuvendi i Shqipërisë, datë 17.12.2015.

Ligji i dekrimalizimit, një dështim!/ Politika ende e inkriminuar edhe pas 7 vitesh. *Top Neës*.

<https://ëëë.youtube.com/ëatch?v=gxupyËzARR8>

Likmeta, Besar. Study Finds Albanian Crime Had Political Ties for 25 Years. *Balkan Insight*,

December 1, 2017. <https://balkaninsight.com/2017/12/01/study-find-that-for-25-years-of-albanian-crime-had-political-ties-12-01-2017/>

OSCE/ODIHR. (2013). *Republic of Albania parliamentary elections, 23 June 2013:*

OSCE/ODIHR election observation mission final report. Organization for Security and Cooperation in Europe, Office for Democratic Institutions and Human Rights.

<https://ëëë.osce.org/odihr/elections/107069>

Performance Assessment: Measuring Effectiveness, Monitoring Progress and Enhancing Accountability of Special Prosecution (SPAK) and Special Courts Against Corruption and Organised.

SPAK përfundon hetimet për çiftin Meta-Kryemadhi, ja kur i komunikohen akuzat. A2CNN, 27 maj 2025. <https://a2neës.com/shqiperia/kronike/spak-perfundon-hetimet-per-ciftin-meta-kryemadhi-ja-kur-i-komu-i1149052>

SPAK. Njoftim për shtyp, Datë 21.05.2025 <https://spak.gov.al/njoftim-per-shtyp-date-21-05-2025/>

Geri Emiri. Krimi i organizuar “orientoi” votën në Durrës. 11 maj 2025. Reporter.al. <https://ëëë.reporter.al/2025/05/11/krimi-i-organizuar-orientoi-voten-ne-durres/>

Vladimir Karaj. Sara Mila, ‘fenomeni i çuditshëm’ i zgjedhjeve të Elbasanit. 15 maj 2025. Reporter.al. <https://ëëë.reporter.al/2025/05/14/sara-mila-fenomeni-i-cuditshem-i-zgjedhjeve-te-elbasanit/>

GRECO. Fifth evaluation round Preventing corruption and promoting integrity in central governments (top executive functions) and law enforcement agencies. COMPLIANCE REPORT, ALBANIA. 2023.

GI-TOC. Integrity and independence of criminal justice institutions in the Eastern Balkans Police and prosecution. 2024. <https://globalinitiative.net/analysis/integrity-and-independence-of-criminal-justice-institutions-in-the-eastern-balkans/>

GI-TOC. Integrity and independence of criminal justice institutions in the Eastern Balkans. 2024: Final report. <https://globalinitiative.net/analysis/integrity-and-independence-of-criminal-justice-institutions-in-the-eastern-balkans/>



INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE

Web: www.isp.com.al

E-mail: contactaips@isp.com.al

Facebook: Instituti i Studimeve Politike / Institute for Political Studies

Adresa: Rezidenca "Garden Side", Rr " Faik Konica", Kati 1, Ap. 3, Tiranë